



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1392, datë 23.09.2010

Për

“Mbylljen e procedimit administrativë të filluar me VKD nr. 1329, datë 15.07.2010 të AKEP “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 23.09. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Mbylljen e procedimit administrativë të filluar me VKD nr. 1329, datë 15.07.2010 të AKEP “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.” të shoqëruar nga:

- Raporti përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, pretendimet**):

BAZA LIGJORE :

1. Neni 120 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);

2. Neni 66-104 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin e miratuar me VKD nr. 416, date 7.12.2007 e ndryshuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, **e ndryshuar;**
4. Rregullore per Proçedurat e Zgjidhjes së Momarrëveshjeve e miratuar me VKD nr. 1296, date 11.06.2010;
5. Oferte Referencë e Interkoneksionit për AMC;
6. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1329, datë 15.07.2010 i KD të AKEP “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.;
2. Shkresë e AKEP nr. 2511/4 prot, datë 19.07.2010 “Njoftim Vendimi nr.1329 datë 15.07.2010 të KD të AKEP”, drejtuar sipermarrësit Albanian Mobile Communications sh.a.;
3. Shkresë e AKEP nr. 2511/5 prot, datë 19.07.2010 “Njoftim Vendimi nr.1329 datë 15.07.2010 të KD të AKEP”, drejtuar studios ligjore Tonuci & Partners;
4. Projektvendim i KD te AKEP për “Mbylljen e procedimit administrative të filluar me VKD nr.1329, datë 15.07.2010, mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve, MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a. (**Projektvendimi**);
5. Raport përmbledhës mbi projektvendimin (**Raport**);
si dhe,
6. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;
7. Bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e:

- I. Mbi detyrat e lëna për sipërmarrësit, mbi depozitimin e pretendimeve me shkrim deri më 30.07.2010, bazuar ne pikën 3 të Vendimit nr. 1329, datë 15.07.2010, “Për fillimin e procedimit administrativ mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a. (në vijim AMC);

1. MSI Telecom sh.p.k me shkresën e datës 26.07.2010 (AKEP: nr. 2511/6 Prot, datë 26.07.2010) “Parashtrim pretendimesh dhe prova shkresore” sqaron se:

- a. AMC në mënyrë të pa drejtë dhe të kundraligjshme pengon lidjen e marrëveshjes së interkoneksionit (në vijim MI) për shërbimet zanore midis MSI dhe AMC, bashkëlidhur korrespondenca e negociatave midis palëve si me poshtë vijon:
 - Shkresë e MSI Telecom, dt. 17.09.2009 “Kërkesë për lidhje interkoneksioni”;
 - Vijuar me shkresën e MSI Telecom, dt. 21.01.2010 “Kërkesë për lidhje interkoneksioni”;
 - Shkresë e AMC, nr. 384/1 prot, dt. 09.02.2010 “Në lidhje me kërkesën për lidhje interkoneksioni”;
 - Shkresë e MSI Telecom, dt 05.03.2010 me objekt “Kthim pergjigje e shkreses së AMC dt. 09.02.2010”;
 - Shkresë MSI, dt. 06.05.2010 “Kërkesë për vijim të negociatave për nënshkrimin e marrëveshjes së interkoneksionit”;
 - b. MSI pretendon se kjo pengesë nga AMC është në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 9918 dt. 19.05.2010 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” në kundërshtim me neni 4 të rregullores për akses dhe interkoneksion dhe në kundërshtim me përcaktimet për ofertë reference për interkoneksion të AMC;
 - c. MSI konsideron se AKEP në zbatim të nenit 60 të ligjit nr. 9918 dt. 19.05.2008 si dhe në shënimet sqaruese për mundësin e realizimit teknik të interkoneksionit bashkëngjitur shtojcës 3, duhet të urdhërojë lidhjen e MI midis MSI dhe AMC;
2. AMC, me shkresën nr. 384/3 Prot, dt. 28.07.2010 (AKEP nr. 2511/7 Prot, dt. 28.07.2010) “Përgjigje mbi kërkesën e Vendimit nr. 1329, dt. 15.07.2010 mbi fillimin e procedimit administrativ për kompaninë MSI” sqaron se:
- a. AMC e ka konsideruar kërkesën e MSI duke i kërkuar informacion në përputhje me RIO të aprovuar nga AKEP, në mënyrë që të projektohet një zgjidhje teknike e optimale për mundësinë e interkoneksionit midis rrjeteve, ndërkohë e ka informuar operatorin MSI se nuk ka mundësi teknike për të ofruar kapacitete, si rrjedhojë e kapaciteteve të kufizuara, të hapsirave të kufizuara si me dhomën e switche-ve apo problemet me hapsirat për kabllo të fibrave optike të ***cilat nuk kanë më vend për kablo të reja;***
 - b. Per sa më sipër AMC, thekson se kapacitetet e kufizuara janë krijuar përshtetë edhe të një *upgrade* të gjerë të switcheve të AMC, i cili është i domosdoshëm për dy arsye:
 - Çentralet tona janë në operim që prej vitit 2000, pra i përkasin nje teknologjie të vjetëruar dhe kanë arritur nje saturim nga pikpamja e

kapaciteteve (lejojnë interkoneksion vetem ne E1 dhe jo STM1, fibër etj.);

- Me zhvillimet e reja si Portabiliteti i numrit dhe 3G, *upgrade* i mësipër përmëndur bëhet akoma më i domosdoshëm për të përgatitur infrastrukturën e rrjetit të AMC për të suportuar teknologjinë e re;
- c. AMC konsideron se procesi kalimit në gjeneratën e re të swicheve (MSS/MGW), është i komplikuar, i kushtueshëm dhe kërkon kohë duke patur parasysh procedurat e prokurimit të dizenjimit, të delivery dhe të migrimit;
- d. AMC, thekson se nuk është e rëndësishme lidhja e MI ne letër, por implementimi i saj fizik pas lidhjes së MI, por meqënëse për momentin kapacitetet e AMC janë të ezauruara, sygjeron që MI të lidhet në një fazë të më vonshme;
- e. Për sa më sipër AMC sqaron se, në momentin që kapacitetet do të jenë të optimizuara, të gjitha kërkesat e operatorëve për lidhje direkte interkoneksioni do të konsiderohen në mënyrën më të shpejtë të mundshme;

II. Për sa më sipër Keshilli Drejtues konstaton se:

1. AMC ka justifikuar mos-lidhjen e marrëveshjes së interkonkesionit me MSI Telecom për shkak të pamundësisë teknike për lidhje direkte.

Operatori ofrues i interkoneksionit AMC, nuk mund të detyrohet të ofrojë akses për interkoneksion kur nuk ekzistojnë mundësitë teknike, por në zbatim edhe të pikës 4 të nenit 6 të Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga AKEP me VKD nr.1300 datë 14.06.2010, e ndryshur me VKD nr. 1373, datë 10.09.2010 (në fuqi prej datës 10.09.2010),

“Operatori ofrues, në rastet kur refuzon t’i sigurojë operatorit përfitues shërbimet e specifikuar në ofertën referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin t’i paraqesë operatorit përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur operatori ofrues refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuar në ofertën referencë për operatorin përfitues për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori ofrues duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë operatori përfitues me qëllim që operatori ofrues të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur operatori ofrues paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen njëkohësisht dhe AKEP-it”.

2. Edhe në rast të vërtetimit të pamundësisë teknike të AMC, shpjegimi i dhënë nga AMC nuk ka përfshirë afatin kohor të saktë se kur mund të përmbushet kërkesa si dhe kur do të jetë i mundur realizimi i interkoneksionit direkt apo

përfundimi i punimeve në rrjet, çka është në kundërshtim me rregulloren e Aksesit dhe Interkoneksionit;

3. MSI Telecom ka nënshkruar marrëveshje interkoneksioni me Albtelecom sh.a dhe Vodafone Albania sh.a;
4. AKEP, bazuar në kapacitetet teknike, menaxheriale dhe ekonomike të AMC, gjykon si të arsyeshme lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit midis AMC dhe MSI Telecom brënda 30 ditësh nga data e publikimit të vendimit në faqen e Internetit të AKEP;

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të mbyllë procedimin administrativë të filluar me VKD nr. 1329, datë 15.07.2010 për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni midis sipermarrësve MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a.;
2. Operatori ofruer AMC të lidhë marrëveshje interkoneksioni me MSI Telecom sipas percaktimeve të Urdherit Bashkëngjitur, brënda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi;
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë :

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

U R D H Ë R

Nr.10, date 23.09.2010

Për

“Lidhjen e Marrëveshjes për Akses dhe Interkoneksion midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe MSI Telecom sh.p.k”

Në mbështetje të nenit 60 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Keshillit Drejtues (VKD) të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010, Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, VKD nr.1392 datë 23.09.2010 “Për Mbylljen e procedimit administrativë të filluar me VKD nr. 1329, datë 15.07.2010 të AKEP “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis MSI Telecom sh.p.k dhe Albanian Mobile Communications sh.a”

U R D H Ë R O J:

1. Albanian Mobile Communications sh.a dhe MSI Telecom sh.p.k të lidhin marrëveshje interkoneksioni brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhëri;
2. Marrëveshja e Interkoneksionit të lidhet sipas përcaktimeve të ofertes referencë të interkoneksionit në fuqi të Albanian Mobile Communications, dhe marrëveshjeve të lidhura me palët e tjera;
3. Palët të depozitojnë në AKEP një kopje të Marrëveshjes së Interkoneksionit të nënshkruar nga palët brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes së interkoneksionit;
4. Moszbatimi i këtij urdhëri përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë sipas parashikimeve të nenit 137 të ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A N Ë T A R Ë:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**